

## **V E N D I M**

**Nr. 496, datë 13.9.2017**

### **P Ë R**

**DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.332, DATË 17.3.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E FORMËS, ELEMENTËVE PËRBËRËS, MËNYRËS SË MBAJTJES E AFATIT TË PËRDORIMIT TË DOKUMENTEVE BAZË, QË MBAHEN DHE LËSHOHEN NGA SHËRBIMI I GJENDJES CIVILE", TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 25, pika 4 dhe 69/1, pika 2, të ligjit nr.10129, datë 11.5.2009, "Për gjendjen civile", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

### **V E N D O S I:**

1. Në vendimin nr.332, datë 17.3.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

"2/1. Certifikatat personale dhe familjare, të ofruara përmes shërbimit publik elektronik, në përputhje me legjislacionin që rregullon identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara, lëshohen me nënshkrimin dhe/ose vulën elektronike të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, sipas modeleve nr.1 (elektronik) dhe nr.2 (elektronik), bashkëlidhur këtij vendimi si pjesë përbërëse e tij."

b) Në lidhjen nr.1, bashkëlidhur vendimit, shtohen modelet nr.1 (elektronik) dhe nr.2 (elektronik), që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

Botuar në Fletoren Zyrtare NR.166, datë 19 shtator 2017